

Tiranë, 8 prill 2026

ISP: Shqetësime lidhur me vonesat për shpalljen e zgjedhjeve të pjesshme në Rrogozhinë dhe për jetësimin e standardeve të dekriminalizimit & integritetit, nga institucionet dhe partitë politike

Kuvendi ka në agjendë **reformën e re territoriale dhe zgjedhore**, si dhe debatin mbi autonominë vendore dhe **përmbushjen nga Shqipëria të kriterëve të shtetit të së drejtës dhe demokracisë funksionale** në raport me synimin e anëtarësimit në BE. Në këtë kontekst informojmë se ISP po kryen edhe monitorimin e integritetit të zgjedhjeve dhe jetësimin e standardeve të dekriminalizimit për zyrtarët e lartë, elementë të rëndësishëm që ndërlidhen edhe me agjendën institucionale të Kuvendit dhe të vendit.

Instituti i Studimeve Politike (ISP) ka ndjekur edhe rastin e bashkisë Rrogozhinë. Konkretisht, me **9 shkurt 2026 Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** shpalli vendimin për lënien në fuqi të vendimit nr. 8, datë 24.01.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për dënimin me 1 vit burg për kryetarin e bashkisë Rrogozhinë, E. Memolla, i akuzuar për kryerjen e veprës penale **“Korrupsioni aktiv në zgjedhje” kryer në bashkëpunim**. Sipas legjislacionit në fuqi, menjëherë, zyrtari humbet postin dhe vijon dënimin në një nga institucionet përkatëse.

Në përputhje me ligjin, një ditë më pas, **me 10 shkurt 2026** është mbledhur Këshilli Bashkiak Rrogozhinë. Sipas njoftimit zyrtar të mbledhjes, Këshilli u njoh me përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë z. E. Memolla, për shkak të dënimit penal me vendim të formës së prerë, në zbatim të nenit 62 të ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar. Këshilli vendosi ushtrimin e përkohshëm të funksioneve të Kryetarit të Bashkisë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri nga zëvendëskryetari. Me rëndësi, në pikën 5 të mbledhjes Këshilli vendosi **“njoftim i Këshillit të Ministrave nëpërmjet Prefektit të Qarkut Tiranë, për përfundimin e mandatit të kryetarit përpara afatit, sipas pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar”**.

Deri në këtë pikë gjithçka është në rregull në aspektin ligjor. Gjykata vendos, zyrtari humbet funksionin dhe përballet me pasojat penale, Këshilli Bashkiak konfirmon përfundimin e mandatit dhe njofton qeverinë përmes Prefektit.

Legjislacioni parashikon më tej se Këshilli i Ministrave informon Presidentin e Republikës dhe KQZ, dhe Presidenti brenda 48 orëve shpall zgjedhjet e reja për kryetar bashkie (në Rrogozhinë). Zgjedhjet zhvillohen jo më herët **se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë** nga data e daljes së dekretit nga Presidenti. Procesi zgjedhor organizohet nga KQZ dhe përfundon me

shpalljen e rezultatit dhe marrjen e mandatit nga kryetari i ri, për pjesën e mbetur të mandatit deri në maj 2027.

Ky është ligji (Kodi Zgjedhor dhe Ligji “Për vetëqeverisjen vendore”. Nëse do të ishin respektuar afatet Prefekti i Tiranës do të kishte informuar Këshillin e Ministrave me 11-12 shkurt 2026, Këshilli i Ministrave do të kishte informuar Presidentin dhe KQZ me 13-15 shkurt 2026 dhe Presidenti do të kishte dekretuar zgjedhjet e reja në Rrogozhinë midis 15-25 mars 2026. Jemi në muajin prill dhe **ende Këshilli i Ministrave nuk ka kryer detyrimin e vet ligjor** për raste të tilla.

Nga monitorimi i praktikës nga Instituti i Studimeve Politike (ISP) konstatohet me shqetësim se edhe në raste të mëparshme institucionet, sidomos Këshilli i Ministrave, **nuk e ushtrojnë në kohën e përcaktuar ligjore funksionin dhe përgjegjësitë e vet** dhe për pasojë vendimi real për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme (kur krijohen vakanca) imponohet nga agjenda politike e qeverisë dhe jo nga logjika procedurale ligjore. **Ligjet duhen respektuar pavarësisht interesit politik të palëve të përfshira në procese të tilla. Ky është një standard dhe një detyrim i panegociueshëm për një vend që po synon anëtarësimin në BE.**

ISP ka konstatuar gjithashtu se zyrtari i dënuar **që humbet postin, vijon të ketë ende anëtarësi efektive në strukturat drejtuese të forcës së vet politike**, - nuk ka pasur asnjë njoftim për jetësimin e standardeve të dekriminalizimit jo vetëm në bashki por edhe në partinë respektive politike. Figura të njohura politike të partisë së tij e kanë marrë publikisht në mbrojtje, një **shans i humbur për të distancuar politikën nga rastet e krimeve zgjedhore** dhe zyrtarëve që provohen se kanë shkelur ligjin. Gjithashtu, është konstatuar se më faqen zyrtare të bashkisë¹ vijon të figurojë kryetar, ish-kryetari i dënuar për korrupsion aktiv në zgjedhje, një tregues tjetër shmangie nga standardet e transparencës, informimit, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve përfaqësuese.

Bazuar në këto të dhëna,

- **ISP apelon qeverinë të ushtrojë detyrimet e veta ligjore** dhe administrative për të jetësuar daljen e dekretit nga Presidenti për zgjedhjet e pjesshme në Rrogozhinë;
- **apelon KQZ që të sugjerojë zgjidhje më efektive** të praktikave të tilla tani e në të ardhmen;
- **apelon partinë respektive politike të respektojë parimet e dekriminalizimit** dhe integritetit për zyrtarët e lartë të sanksionuara edhe në Kodin e saj të sjelljes në parti;
- **si dhe bashkinë Rrogozhinë të jetesojë standardet ligjore të transparencës**, duke rifreskuar edhe të dhënat lidhur me motivet dhe përfundimin e mandatit të kryetarit të bashkisë.

Instituti i Studimeve Politike (ISP)

¹ <https://bashkiarrogzhine.gov.al/>